

Dy persona ia grabisin taksistit 90 euro nën kërcënimin e armës

LAJME



11/05/2022 08:44



Policia e Kosovës, ka njoftuar se dje gjatë ditës një taksist ka raportuar se i janë grabitur rreth 90 euro, nga dy persona.

Përmes raportit të saj të përditshëm, PK-ja, shton se dy të dyshuarit i kanë kërkuar viktimës që t’i dërgojë në fshatin Grashiticë, ku edhe e kanë kërcënuar me revole viktimën e me pas edhe e kanë grabitur, shkruan [lajmi.net](#).

Tutje, shtohet se rasti është nën hetime.

“GRABITJE. Fsh. Grashiticë 10.05.2022 – 00:10. Ankuesi mashkull kosovar punëtor-voztës Taxi ka raportuar se nga qendra e Prishtinës kishte dy pasagjer të cilët kishin kërkuar që të i dërgoj në fshatin Grashiticë dhe pasi që kishin arritur në atë lokacion, njëri prej tyre i kishte ekspozuar armën e zjarrit-revole dhe nën kërcënimin e armës ia kishin grabitur rreth nëntëdhjetë (90) € para te gatshme si dhe dy telefona te firmës. Rasti nën hetime”, thuhet në komunikatë. [/Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm



May 11, 2022

Mësimdhënësit nesër në grevë, Jasharaj: Paralajmërim për veprime më të rënda...



May 11, 2022

Prishtinasi s’e duron kolonën, e kalon Veternikun përmes trotuarit



May 11, 2022

Eksportet me Maqedoninë e Veriut u rritën me mbi 2 herë



May 11, 2022

Ukraina bën përparime në lindje, pezullon dërgesat e gazit rus



May 11, 2022

“Jo vetëm rritje të çmimeve, por edhe abuzim më të drejtat...



May 11, 2022

Ruzhdi Kurtishaj: Ngritja e çmimeve të naftës goditi rëndë transportin rrugor...